



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/207  
Datë: 30.05.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, nenit 14, paragrafit. 6. të Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 577,900.00 € (pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqindë euro) në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me kod 207, për zbatimin e Programit "Masat Preventive, Intervenime Emergjente nëpër komuna të ndryshme".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi, rialokohen nga nën-programi "Mbrotjtja, Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore" me kod 81500 nga kategoria e shpenzimeve kapitale, përkatësisht nga Projekti "Masat Preventive, Intervenime Emergjente" me kod 12688, dhe rialokohen në këto projekte, konform shumave të cekura:
  - Shtëpia tradicionale Rysht Kepuska, Gjakovë, me kod 15677, në shumë prej 1,000€;
  - Kulla e Zeqë Ramë Sadrisë, Brovinë, me kod 15685 në shumë prej 1,517.00€;
  - Kulla e Ymer Poges, Rogovë e Hasit, Gjakovë, në shumë prej 80,000.00€;
  - Kulla e Fetah Kurexhajt, Kurexhaj, Gjilan, në shumë prej 11,080.00€;
  - Objekti i Teknikes Popullore, Gjilan, në shumë prej 134,000.00€;
  - Shtëpia e Xhafer Deves (Shek. XIX) Mitrovicë, në shumë prej 10,000.00€;
  - Ndërtesa e Ish Bankosit, Mitrovicë në shumë prej 8,305.00€;
  - Kulla e Tahir Mehes, Prekaz në shumë prej 15,000.00€;
  - Burgu i Gjurakocit, me kod 19247 në shumë prej 40,950.00€;
  - Kulla e Dhanit "Adem Zajmi", Pejë në shumë prej 14,960.00€;
  - Kulla e Goskajve, Pejë, në shumë prej 136,530.00€;
  - Kulla e Haxhë Mustaf Lajçit, Pejë, me kod 18462 në shumë prej 8,275.00€;
  - Kulla në Oroberdë / Istog, me kod 15510 në shumë prej 27,383.00€;
  - Shtëpia Nr.10 në Qytetin e vjetër në Janjevë, Lipjan, në shumë prej 4,300.00€;
  - Shtëpi banimi - Musli Hoxha, Prishtinë në shumë prej 84,600.00€.
3. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve si dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



---

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/207  
Datë: 30.05.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2024, merr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme ish shoqërore P. Sh IGK "Ballkan", Njësia Damber, (ish Kampi "Casablanka"), për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, Zona Kadastrale Suharekë, Komuna Suharekë, sipas tabelave të bashkëngjitura këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij Vendimi janë raportet e vlerësimit për sipërfaqen e tokës, strukturat, investimet, pjesët aksesor, druaj të ndryshëm pyjor dhe frutor, të punuar nga Departamenti për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat e bashkëngjitur këtij Vendimi në të cilat është përcaktuar shumat e kompensimit për tokën dhe investimet në prona për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon Vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij Vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky Vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i Vendimit Përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij Vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë Vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtroesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjislationit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/207  
Datë: 30.05.2024


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 11, 44 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2024, merr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i "Projekteve Infrastrukturore për Interes Publik", Zonat Kadastrale: Bistricë, Bistricë e Shalës, Dren, Leshak dhe Koshotovë, Komuna Leposaviq dhe Zonat Kadastrale: Bërnjak, Zubin Potok, Bregu i Madh, Banjë dhe Jasenovik i Epërm, Komuna Zubin Potok, sipas tabelave të bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi janë raportet e vlerësimit të punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe tabelat të bashkëngjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
3. Brenda pesë (5) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij Vendimi, Departamenti i Shpronësimit bënë shpalljen e Vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.
5. Kundër këtij Vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkëngjitura të këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të Vendimit Përfundimtar dhe aplikimit të pronarit për pagesë të pronës, Departamenti i Shpronësimit nga buxheti i Qeverisë së Kosovës do të paguajë shumën e kompensimit të shpronësimit të caktuar në raportet e vlerësimit komfor legjisllacionit në fuqi.
8. Ky Vendim bashkë me pjesët tabelore dhe grafike (elaboratit të shpronësimit) të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, Agjencia Kadastrale e Kosovës është e obliguar të kryej veprimet procedurale për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**



\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/207  
Datë: 30.05.2024

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, për Projektin "Edukimi në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi për Kapitalin Njerëzor të Kosovës".
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/207  
Datë: 30.05.2024

Në mbështetje të nenit 17 paragrafi 1, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafit 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2024, merr këtë:

**V E N D I M**

- Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës, dhënien e autorizimit Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin "KOMPAS - Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë".
- Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në pajtim me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
- Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë